



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 95/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 04.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 31.05.2014, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se më datë 30.05.2014 subjekti politik LDK ka vendosur billboarda të kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës në hapësira, trotuare të sheshit të qytetit në rrugën Dëshmorët e Kombit, ku sipas ankuesit me këto veprime ka ngushtuar qarkullimin e lirshëm të qytetarëve. Sipas parashtruesit të ankesës këto veprime janë të sanksionuara me neni 33 pika b) të LZP-së, dhe neni 3 pika 2 të Rregullës Nr. 01/2012. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të neni 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK më datën 31.05.2014, për ankesën që është bërë ndaj tyre dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 02.06.2014 deri në ora 10:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga LDK-ja, në të cilën theksohet se me ankesën e PDK-së të ushtruar ndaj subjektit tyre i konsiderojnë si të pabazuar nga fakti se billboardet dhe sitillajtjet e kandidatëve të LDK-së të cilat i referohet ankesa janë vendosur në hapësirat e dedikuara dhe të lejuara për marketing dhe reklamim. Në bazë të përgjigjes në ankesë, këto sitillajte janë të vendosura më herët me lejen e organeve përkatëse, andaj në asnjë mënyrë nuk bie ndesh me Ligjin e Zgjedhjeve dhe me asnjë normë ligjore nuk është e ndaluar vendosja e sitillajteve në hapësirën e brendshme të rrethrotullimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se subjekti politik LDK ka vendosur posterët e kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës në rrugë publike të cekur në ankesë, nuk qëndrojnë sepse në bazë të fotografive të ofruara si dëshmi, vërtetohet se posterat janë vendosur në vendet ku janë të dedikuara për reklama dhe me këtë rast nuk është bërë ndonjë veprim i ndaluar që është sanksionuar me LZP. Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 95/2014 më datën 04.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*